



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 08 Datë 28.01.2021

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR POGRADEÇ
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP ☐ • Reklamim nga të tretë ☒
Numri i procedurave të verifikuara	1 (një)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë prokurimi me vlerë të vogël
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me kriteret e vendosura në ftesën për ofertë. 2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me vlerësimin e operatorëve ekonomikë. 3. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 66 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, për të kërkuar sqarime nga ofertuesit apo nga institucionet kompetente për dokumentacionin e operatorëve ekonomikë.
Masat e marra	Në bazë të neneve 13, pika 2/i, 66 dhe 72, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP vendosi t’i propozojë titullarit të Autoritetit Kontraktor, marrjen e masës disiplinore ndaj 3 (tre) anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.